



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më 26.9.2011, ora 12,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi.

Munguan : Liburn Aliu, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtarët nga Ministria e MB dhe MMPH, bashkëpunëtor, përfaqësues nga komunat, AKP dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje (degjim publik) u propozua ky rend dite:

1. Degjim publik rreth projektligjit për Rregullimin e tokës

Kryetari Nait Hasani konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe në fillim falenderoi në pjesëmarrje, hapi degjimin publik duke arsyetuar kërkesën e komisionit-GP për këtë takim ngase grumbullimi i tokave dhe rregullimi i tyre janë një punë e veçantë që ndikon në zhvillimin e bujqësisë, përndryshe kështu si është tani toka jonë, ajo do të betonohet e tëra. Gjeneratat kanë për obligim të rregullojnë çështjet për zhvillim të gjithmbarshëm.

Nijazi Idrizi gjithashtu falenderoi për pjesëmarrje dhe në cilësinë e kryesuesit të GP tha se komisioni ka nevojë për sugjerime për punën e metejme sidomos edhe sa i përket konsolidimit të fermave ngase lidhet me procesin e rregullimit të tokave. Gjate vitit 1989 ky proces ka filluar si mase e komasacionit në 8 komuna mirepo ka mbetur e paperfunduar, ndërsa tani me projektligj parashihet të vazhdoi puna por në baza vullnetare. Për fat të keq Kosova e ka tokën shumë të segmentuar, vazhdoi, e cila gjë e rëndon shumë sektorin e bujqësisë por gjithashtu edhe fermat bujqësore që posedojnë tokën bujqësore nuk trajtohen si duhet, ngase pa konsolidimin e tokës bujqësore nuk konsolidohen as fermat bujqësore dhe bujqësia në tërësi.

Salih Morina u fokusua në rendesinë e ligjit ngase pas luftës ka nevojë të ndalet degradimi i tokës bujqësore me çka ky komision shpreson të modifikoj problemet aktuale me këtë tokë përmes këtij ligji.

Përfaqësuesi nga Rahoveci propozoi që të neni 21 edhe në pikën 2 të përdoret fjala “pjelloria” ngase fjala “bonitet” nuk është fjale adekvate. Ndërsa të kreu VII përveç pjesëmarrësve në

komasacion te caktohet edhe sipërfaqja e tokes (sa duhet te jete minimumi i tokes qe perfshihet me komasacion).

Tefik Maloku – perfaqesues nga Vushtrria u fokusua te neni 12 pika 9 ku ceket hapja e konfliktit administrativ per rastet e mospajtimet te pales, ndaj per shkak te trashigimit te problemeve me palet, pyeti çka nëse pala nuk pajtohet me rregullimin e tokes sipas vendimit te gjykatës. Ka pas raste kur edhe pas refuzimit të ankesës nga Gjykata, pala ka vazhduar të shfrytëzoj tokën. **Nasuf Aliu** gjithashtu perfaqesues nga Vushtrria kerkoi qe te mundesohet dergimi i verejtjeve ma vone lidhur me kete projekt, ngase koha ka qene e shkurter nga dita e dergimit te fteses. **Nait Hasani** nuk kundërshtoi kete sugjerim ngase komisioni ende do te miret me kete projektligj por theksoi se kjo tregon sa te pergjegjshem jane komunat, edhe me faktin se sa prezentojne ne degjimin e sotëm, ngase tokat janë të komunave. Prej 34 komunave sa janë ftuar për sot, shihet prezenca simbolike vetëm i disa komunave. Edhe **Nijazi Idrizi** tha se kjo eshte fillimi i punes dhe puna nuk mbyllet me sot, ngase ky ligj është përtej komasacionit pasi që do të përfshijë edhe dimensionin ekonomik për tokat bujqësore, ndoshta edhe dimensionin social, mjedisor etj

Perfaqesuesi i Ministris se Bujqesise theksoi se me kete ligj synohet te krijohet baza ligjore per rregullimin e tokave, menaxhimin e tokave pjellore dhe klasifikimi i tyre, ndaj normale eshte te perfundoj me konflikt administrativ per ata qe nuk pajtohen, ngase kemi te bejme me konsolidim vullnetar. Sa i perket verejtjes për nenin 32 me pesë anëtarë, ai tha se është shkuar nga ajo që baza fillestare të jetë numri i pjesëmarrësve e jo sipërfaqja e tokës bujqësore. Ndërsa sa i perket ankesës në Gjykatë, fjala është për shterjen e mjeteve juridike, ndaj pasi që përfundon procedura administrative pason ajo gjyqësore. Në hartimin e këtij ligji kanë marr pjesë edhe ekspertët ndërkombëtar përmes projektit EULUP-projekt për shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokave bujqësore, përfundoi ai. **Idriz Gashi** poashtu nga MB, tha se ligji synon rritjen e konkurrencës së fermës, përmirësimin e vetive të tokave dhe është ligj i domosdoshëm duke u bazuar në perspektivat evropiane. Ky ligj ka zgjedhur principin vullnetar të konsolidimit të tokave ngase është vlerësuar si bazë e mirë për trajtimin e këtij problemi. Për diskutimin rreth 5 fermerëve ai tha se edhe në ligj shkruan se është iniciativë vullnetare, ndërsa në aspektin më të gjerë duhet të pajtohen 2/3 e pronarëve për me fillua projekti i konsolidimit të tokave.

Hajzer Bublatu nga Agjencia Kadastrale tha se ne kete takim ka pritur te degjoj me teper problemet e komunave ngase : 1. konceptet vullnetare deri tani nuk jane treguar aq te dobishme (Reagoi **Shefki Zeqiri** dhe tha se perkunder ketij fakti puna ka filluar mire). Kjo bazë vullnetare që kërkon pajtimin e 2/3 të pronarëve mund të krijoj probleme. 2. Ai shfaqti mospajtimin edhe me faktin se ne projekt shkruan se Sekretariati do te mbështetet nga komuna, çka nuk është ne rregull, ngase ky organ duhet te mbështetet nga ministria ngase është organ i tij (ai tha :”ndoshta po flas në emër të komunave, por realisht kështu mendoj”). Ministria duhet ta merr përgjegjësinë për krejt procesin. 3. Në aspektin e buxhetit neni 29 parasheh shpenzimet financiare të cilat barten nga ministria, ku parashihen edhe obligime për pronarët, mirëpo ligji duhet saktë të caktoj shpenzimet p.sh. për infrastrukturë të kërkohej një sipërfaqe e caktuar dmth pronari duhet ta dijë saktë për obligimet e veta. 4. Sa i perket sanksioneve, operatorit i caktohet dënimi, çka nuk është në rregull ngase ai nuk duhet te dënohet, me kete mase vetem behet i padisiplinuar, dmth ai duhet te edukohet per te kryer detyrat me kohe e jo te denohet. 5. Sa i perket komasacionit te paperfunduar ajo paraqet nje problem serioz ngase ministria duhet të ketë qartë politikën : mos të pranon ndryshimet e komasacionit atëherë që u ba dhe të fillon përsëri te shkapërderdhe tokat, ngase atëherë faza e parë e komasacionit ka përfunduar plotfuqishëm me vendimet e komisionit të komasacionit, faza e dytë e posedimit me gjendje të re dhe e treta (më kritike) ku ato vendime kanë krijuar pasoja juridike (disa gjykata kanë kryer trashëgime me ato vendime), kryhen shitblerjet, transaksionet e ndryshme etj dmth duhet të ndahet kjo pjesë-fazë ku vendimet gjinden në nivel të realizueshmërisë teknike, por ka mbetur pa u realizuar në kadastër ngase siç dihet na është marr dokumentacioni nga Serbia. Pra duhet një dispozitë ligjore e cila garanton kontinuitetin e punës së atëhershme me të tashmen (ai sugjeroi që mos të hyjmë këtyre ndryshimeve të atëhershme). Poqes prapë ministria dëshiron te zhvilloi masën komasative ne

keto parcela te perfunduara nje herë, kjo duhet te behet me vendim politik, duke marr gjendjen faktike të tanishme, perfundoi ai.

Xhevat Azemi nga AKP ne fillim konstatoi : nese nuk zbatohet Ligji per token bujqesore dhe Planifikimin hapësinor, nje dite nuk do te kemi çka me rregullua, dmth ne rend te pare vijne tokat bujqesore dhe planet hapesinore pastaj rregullimi i tokave. Me kete ligj synohet baza ligjore ne kete fushe. Ministria më 2004 është munduar të përfshijë në Ligjin për token bujqësore çështjen e komasacionit por ka qenë vështirë. Per nenin 30 dhe 31 ai tha se u konsultua me perfaqesuesin e MB si duhet te jete. Çështja thelbësore është se komasacioni vullnetar synohet te kryhet me pelqimin e 2/3 te pronareve, ne menyre qe edhe nese nuk pajtohen 1/3 nuk mund te paraqesin pengese serioze, ngase edhe kjo perqindje me vone do te pajtohet. Me këtë ligj bartëse kryesore e rregullimit të tokës është ministria, por duhet të dihet se projektet vullnetare vështirë realizohen ngase kanë ndikuar : 1. ndryshimin e konceptit te vleres se tokes, ngase pas luftes tokat afer rruges kane vlere me te larte, 2. dokumentacioni kadastral dhe mungesa e vullnetit të pronarëve për projekte vullnetare. Komascioni i papërfunduar është problematike sepse atëherë (vitet 80-ta) komisioni ka rregullua edhe çështjet pronësore por tani ky komision me këtë ligj këtë autorizim nuk e ka. Tjetër problem është se tani fermerët edhe vet nuk dinë saktë pronën e vet, kjo krijon probleme të mëdha në institucionet publike (nga vendimet). Agjencia e privatizimit ka mjaft kësi lloj problemesh dhe gjithashtu gjykatat kanë vështirësi në zbatimin e atyre vendimeve, sepse ka një mori kërkesash që kërkojnë zbatimin e vendimeve të komasacionit, ka raste kur edhe mëshefet vendimi i komasacionit, sepse pala dëshiron të kthehet gjendja para komasacionit, rast tjetër është kur gjendet dokumentacioni por krijohet dilema cilës provë ti besohet. Tash për tash me këto lëndë asgjë nuk veprohet ngase mendojnë në APK se prishen projektet e komasacionit të atëhershëm, dhe pritet që MB ti zbatoj projektet e veta dhe të zgjidhen problemet. Ka raste, vazhdoi, kur AKM ka shitur pronën shoqërore, ndërsa në anën tjetër është bërë kërkesa për kthimin e pronës në bazë të vendimit për komasacion. Angazhimi për përfundimin e këtyre projekteve do të ishte shumë i mirëseardhur, përfundoi ai.

Përfaqësuesi i agjencisë së privatizimit tha se ky ligj nuk i prek ata mirëpo kanë lidhje të ngushta. Me rastin e shitblerjeve që janë bërë në këtë agjenci (dhe më herët në AKM) dispozita ligjore në kontratë cek mosndryshimin e destinimit të tokës pa licencë të caktuar, mirëpo ndryshimet kanë ndodhur. Megjithatë ky përfaqësues tha se do të kujdesen që palëve të ju rikujtojnë këtë obligim që e ka kjo agjenci ndaj tokës bujqësore. Te neni 7 thuhet ministria themelon komisionin për çdo projekt, ndaj pyeti a është ky komision ad hoc nëpër komuna apo do të themelohet për çdo komunë me akt nënligjor-erga omnes. Ky komision formohet nga komuna (sqaroi **Shefki Zeqiri**).

Perfaqesuesi i MMPH tha se plani hapesinor eshte koordinator i te gjitha zhvillimeve në hapësirë, pra edhe problemeve qe u than ne kete degjim, dhe shfaqti brengosjen pse nuk kane ardhur perfaqesuesit e komunave, ngase çdo ditë humbim token e klasit I-IV. Çdo ditë nga niveli komunal vinë dhe thonë se ministria po pengon zhvillimin duke ndaluar projektet individuale, çka nuk është e saktë sepse ky është vendi ku ata duhet të vijnë dhe të arsyetojnë kërkesat, por nuk kanë ardhë. Në Kosovë kemi planin qendror hapësinor dhe planet komunale që nxirren në bazë të planit hapësinor, por shqetësimet janë se po rrezikohen zonat rurale me tokë kualitative. Me rëndësi është që kërkesa të bëhet në komunë e cila duhet të konsultohet me nivelin qendror, përfundoi në formë të apelit.

Shefki Zeqiri u përgjigj në disa vërejtje të Hajzer Bublakut se është paraparë me këtë ligj që mos të shfuqizohet puna e mëparshme deri në sqarimet e duhura, ndërsa për vërejtjet e përfaqësuesit të AKP tha se secili pronarë mbanë përgjegjësi për ndryshimet e bëra.

Ne pyetjen e **Nait Hasanit** nese nje pronar midis disa parcelave nuk pajtohet, **Shefki Zeqiri** tha se MB terhiqet ngase kemi te bejme me masen vullnetare. Mirëpo **Nait Hasani** vërejti se çështja vullnetare te ne vështirë po realizohet, ngase edhe sot vullnetarisht janë ftuar përfaqësuesit e komunave por nuk kanë ardhur.

Hajzer Bublaku, Xhevat Azemi diskutuan në vazhdim lidhur me nenin 7 rreth 5 apo më shumë anëtarëve dhe si është më mirë të veprohet.

Avdullah Muli kryetar komasacioni ne Vushtrri tha se ne kete komune kane mbetur ca probleme te vjetra sidomos me nacionalitete te perziera, pala i ka marr mjetet dhe nuk interesohet me. Në këtë ligj thuhet se ministria mund të nxjerr akt nënligjor për sqarimin e pronësisë, ndaj kërkoi që ministria të caktoi si mund të bëhet transaksioni i papërfunduar në mënyrë që të regjistrohet prona. **Xhevat Azemi** per keto raste sugjeroi hulumtimin e dokumenteve nga viti 1980, hapi dyte te vertetohet pronësia. Në AKP është aprovuar një version i veprimit por nuk mund të miratohet pa u aprovuar ligji. Te çështja e bartjeve te transaksioneve joformale ku bleresi nuk ka dokumente, ne anen tjeter autorizimi nuk eshte dhene per bartje me kete projektligj ngase eshte delikate për komisionin, shfrytëzohen dokumente te falsifikuara etj. Gjykata duhet te jete ajo qe i analizon te gjitha keto çështje, perfundoi.

Sevdije Lama pyeti per tokat e degraduara (me ndotje etj) pa marr parasysh se jane te tilla, a duhet te perfshihen me PZHU te komunave, per çka zyrtari i ministrise tha se ato me komasacion do te perfshihen patjetër sepse ministria financon projektet e rregullimit (pyetjen e znj. Lama e sqaroi edhe **Nijazi Idrizi** ngase pyetja ishte se a do të ringjallen këto ngastra).

Xhevat Azemi për pyetjen e znj. Lama tha se ajo tokë për të cilin flet ajo është e përfshirë në PZHU të Komunës si tokë bujqësore, pavarësisht se është e ndotur lehtë apo rëndë. Pjellorinë e këtyre tokave komisioni i merr parasysh, por kryesore është se ato përfshihen në projekt të komasacionit.

Kryetari ne fund falenderoi.

Mbledhja përfundoi në orën 13,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani